

VENDIM
Nr. 60, datë 10.5.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË HEC “BISTRICA 1
DHE BISTRICA 2” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”; 9, nenit 13 pika 1 germa “ç” dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “f”, nenit 8 pika 4 dhe nenit 10 pikat 1 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pikat 1 germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht (mungon neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetim për shlyerjen e tatim taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore); neni 9, pika 3, germa “b”; (Paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit); neni 9, pika 3, germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe strukturat e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.).

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani